

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i përgjithshëm**, me gjyqtaren e vetme gjykuese Lumnije Krasniqi, me zyrtarin ligjor Leutrim Hoti, në çështjen penale, kundër të pandehurit **F.Q.**, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.7425/16, të dt.01.02.2017, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, PP.II.nr.7425/16, të dt.01.02.2017, më dt.**07.06.2017**, jashtë seancës gjyqësore, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.7425/16, të dt.01.02.2017 dhe kjo gjykatë jep këtë:

### URDHËR NDËSHKIMORË

**I pandehuri: F.Q.**, nga i ati H, e ëma M, e gjinisë K, i lindur me *data e lindjes*, nga fshati S, K. S, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, me gjendje të dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal *numer personal*.

### ËSHTË FAJTORË

#### **S e p s e:**

Me dt. 13.12.2016, rreth orës 17:15, në rrugën magjistrale Prishtinë-Podujevë, në lagjen "...", deri sa i pandehuri ishte duke e drejtuar automjetin e tipit kombi "M B", ngjyrë e kaltër, me targa të regjistrimit *targa te regjistrimit* nga pakujdesia, duke menduar lehtë se nuk do të rrezikoj pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, nuk i është përshtatur shpejtësisë kushteve në komunikacion dhe rrethanave në rrugë, në kundërshtim me nenin 149.1 të LSKRR-së, në vendkalimin për këmbësor, me pjesën e përparme të veturës së tij, e godet këmbësorin i cili ishte duke kaluar rrugën në vendkalim për këmbësor, nga ana e djathtë në të majtë, tani i dëmtuari A.L, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, me dëmtime të përkohshme për shëndetin.

- me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

### DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës.

I pandehuri obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumën prej **40.88 €** dhe ekspertizën mjeko-ligjore në shumë prej **20 €**, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumën prej **20 (njëzet) €**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari A.L nga fshati G, K. S, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.7425/16, të dt.01.02.2017, e ka akuzuar **F.Q**, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: kallëzimi penal nr. 2016-AR-3299, e dt. 13.12.2016, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugorë inxh.dip. B.S, e dt. 15.01.2017, ekspertiza mjeko-ligjore e ekspertit Dr. D.H, e dt.15.01.2017, dhe foto dokumentacioni me shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Pas vlerësimit me shumë kujdes të gjitha provave materiale të lartcekura, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë nga: ekspertiza e ekspertit të komunikacionit inxh.dip. B.S, e dt. 15.01.2017, është konstatuar se deri te aksidentit i trafikut ka ardhur për shkak të lëshimeve nga ana e të pandehurit i cili në pjesën e rrugës ku është vendkalimi për këmbësor, gjegjësisht nuk është i kujdesshëm me rastin e vendkalimit për këmbësor dhe si pasoj e kësaj me pjesën e përparme e godet këmbësorin duke i shkaktuar lëndime trupore i cili në momentin kritik ka qenë duke e kaluar rrugën në vendkalimin për këmbësor nga ana e djathtë në anën e majtë, dhe në këtë mënyrë ka ardhur deri te aksidenti i trafikut në komunikacion me lëndime trupore dhe dëme materiale.

Në bazë të mendimit të ekspertit mjeko-ligjor Dr. D.H, e dt.15.01.2017 për të dëmtuarin A.L, lidhur me natyrën dhe shkallen e lëndimeve trupore konstatohet se i dëmtuari ka pësuar ndrydhje në kokë, përdredhje në qafë si dhe ndrydhje e gërvishtje në gjurin e djathtë, të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë) dhe si të tilla, bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me pasoja të përkohshëm të shëndetit.

Duke u bazuar në këto që u cekën me lartë, gjykata konstaton se i pandehuri F.Q, është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor, është marr në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**P.nr.507/17, i dt.07.06.2017**

Zyrtari Ligjor,  
Leutrim Hoti

Gjyqtarja,  
Lumnije Krasniqi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.